BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1188/1 Prot.

Rrëshen me, 29 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr. 25 datë 29. 03. 2022

PËR
MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK - NDIHMËN DERI NË 6 %, PËR PERIUDHËN 01 – 28 SHKURT 2022", BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të nenit 7 të ligjit nr. 7/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597, datë 04. 09. 2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe në Vendimin nr. 3, datë 31. 01. 2022, të këshillit bashkiak Mirditë, kryetari i bashkisë, (sektori i ndihmës ekonomike), i propozon këshillit bashkiak Mirditë, projekt-vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilat do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar 6 % për bllok - ndihmën, pas verifikimit real nga administratorët social të çdo njësie administrative si më poshtë vijon për muajin **SHKURT 2022:**

1. **Përmbledhëse e muajit SHKURT 2022, ndihmës ekonomike fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën deri në 6%, sipas njësive administrative.**

Nr.	Bashkia Mirditë/Njësitë	Gjithsej numri dhe fondi		Komp. Ener. 6%		Totali
		Nr. Fam.	Fondi 6%	Nr. Fam. Përfituesëve.	Fondi energji Lekë	6%+EN. Energji
1	RRËSHEN	48	134 530	21+6	28 848	163 378
2	OROSH	9	23 848	1	1 288	25 136
3	FAN	11	29 084	2	2 576	31 660
4	SELITË	6	20 174	4	5 152	25 326
5	RUBIK	18	44 550	13+3	17 644	62 194
6	KTHELLË	10	33 440	5	6 440	39 880
7	KAÇINAR	14	30 558	2	2 576	33 134
	TOTAL	**116**	**316 184**	**49+9**	**64 524**	**380 708**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë (sektori ndihmës ekonomike).

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes!

S E K R E T A R

Gasper TOPOLLAJ

K R Y E T A R

Pjeter PJETRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:keshilli@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 405/2 Prot.

Rrëshen me, 29 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr. 26 datë 29. 03. 2022

PËR

"MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE, PËR VITIN 2022'', BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 30, i ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, "Për pyjet", ligji nr. 9693, datë 19. 03. 2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar, VKM nr. 684, datë 02. 09. 2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 433, datë 08. 06. 2016, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave / Bashkive", të ndryshuar, VKM nr. 1080, datë, 22. 12. 2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, *dhe Plani i masave nr. 1205, prot.datë 17.03.2022, hartuar nga sektori i pyjeve,* këshilli bashkiak, pasi shqyrtoi bashkëlidhur edhe projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve, për vitin 2022, bashkia Mirditë.
2. Plani i Masave nr.1205, prot. datë 17.03.2022, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, për ndjekjen e procedurës, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, "Për pyjet".

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

S E K R E T A R

Gasper TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA MIRDITË

K R Y E T A R

Pjeter PJETRI

BASHKIA MIRDITË

Nr1235Prot.

Rreshen , më 17/03/2022

M I R A T O H E T

K R Y E T A R I
Ndrec DEDAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

PLAN - MASASH

Nr._____datë ____ / ____ /2022

" PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2022 "

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore ", në nenin 30 të Ligjit me nr. 57 datë 30.04.2020 " Për pyjet ", Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 , " Për fondin kullosor ", të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 684 datë 02.09.2020, " Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave , " Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish - Komunave /Bashkive " , të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 22.12.2010 " Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", si dhe në zbatim të parashikimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, për parandalimin dhe menaxhimin e situatave që mund të krijohen nga zjarret në pyje dhe kullota dhe me udhëzimet e Drejtorisë së Emergjencave Civile, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore harton dhe miraton tek Kryetari i Bashkise këtë plan masash;

Në këtë plan masash do gjejne vende veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri, dhe konkretisht:

1. Ngritja e shtabit pranë Bashkisë Mirditë për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota.

A.Sh.Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore, deri me datë 20.04.2022

2. Organizimi i sistemit të vrojtim - sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gadishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve, dhe në nivel njësie administrative.

A.Sh.Bujqësore,Veterinare dhe Pyjore, në bashkëpunim me administratorët dhe kryetaret e fshatrave, deri me datë 27.05.2022

3. Organizimi i njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) , me 5 - 15 vullnetarë, për çdo fshate të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj - 15 tetor.

Njësitë administrative në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave ,deri me datë 25.04.2022

4. Planifikimi, shpërndarja dhe përdorimi efektiv i burimeve njerëzore e i mjeteve motorike, i fikseve të shpines, veshembathjeve të posaçme kundra zjarrit dhe veglave të punës në dispozicion dhe administrim të çdo njesie administrative.

Drejtoria e Finances e Buxhetit dhe A.Sh.Bujqesore, Veterinare dhe Pyjore deri me datë 20.05.2022

5. Personat përgjegjës të sektorit te pyjeve, të emergjencave civile dhe të shërbimit zjarrfikës në bashkëpunim me administratorët e njësive vendore si dhe personat përgjegjës të institucioneve të tjera, planifikojnë organizimin e takimeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, në shkolla dhe institucione të tjera shtetërore dhe private, për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen nga zjarri, duke u perqendruar në;

a) Ndalimi në largësi 200 - 300 metra, e ndezjes se zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre, që rrezikon djegien e pyllit ose të kullotës.

b) Ndalimin e tymosjes se bletëve në pyje e kullota, përveç kur ky veprim kryhet me mjete që kanë pajisje të posaçme dhe kapak plotësisht të mbyllur.

c) Mbajtjen nën kontroll të vizitorëve, ekskursionistëve, grupet sportive, gjatë vizitave të tyre në pyje dhe kullota, të blektoreve qe shfrytëzojnë kullotat verore, si dhe të subjekteve apo individeve qe punesohen ne shfrytesimin e lendes drusore dhe te prodhimeve te tjera me origjine pyjore.

ç) Ndalimin e përdorimit te tapave të fishekëve të gjahut prej materiali që merr zjarr lehtë (lini, letër, peceta etj).

d) Ndalimin e djegies se kashtës së të korrave të kulturave bujqësore që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në pyje dhe kullota, pa marrjen e masave parandaluese.

dh) Ndalimin e qitjeve me predha që shkaktojnë zjarr në zonat me drurë pyjorë të thatë dhe mbeturina pyjore (gjethe, shkarpa, kalbësira etj.) e në kullota.

ë) Mbajtjen në gatishmëri te sistemit te lajmërimit dhe mjeteve te komunikimit.

f) Rendesine e raportimit në vazhdimësi për situatën ne raste zjarresh, sipas linjës se varësisë.



13. Djegia e kullotave të infektuara nga barërat e këqija dhe parazitët bëhet me miratimin me shkrim të Agjencisë përkatëse të shërbimit pyjor, sipas nenit 22 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 , " Për fondin kullosor ", të ndryshuar.

Përsoni përgjegjës për pyjet dhe kullotat pranë njesisë vendore ,vazhdimisht

14. Ndezja e zjarreve në brendësi të zonave të mbrojtura bëhet vetëm në zona të përcaktuara nga administrata e këtyre zonave, pasi të jenë marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme që parandalojnë përhapjen e zjarrit.

Specialist të sektorit pyjore, inspektorët e kontrollit te territorit dhe policia bashkiake, vazhdimisht

15. Gjatë operacioneve të parandalimit e të shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota , në të cilat ka banesa ose objekte të tjera civile , njësitë e qeverisjes vendore, personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë dhe organet e shërbimit pyjor bashkëveprojnë me Policinë e Mbrojtjes per Shpëtimit nga Zjarri duke shkëmbyer informacione dhe burime njerëzore e materiale, sipas nevojave respektive dhe mundësive reale. Në këtë kontekst kërkohet plan veprimi i përbashkët ndërmjet këtyre strukturave.

Përgjegjësi i shërbimit zjarrrfikes, përgjegjësi i sektorit pyjore dhe administratorët e njesive administrative, deri me date 27.05.2022

16. Për shuarjen e zjarreve të mëdha marrin pjesë me forca dhe mjete, sipas kapaciteteve që kanë në dispozicion, të gjitha institucionet shtetërore dhe private, njësitë e reparteve ushtarake etj. Në këto raste, shuarja e zjarrit organizohet e kryhet sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin , " Për emergjencat civile ", dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

17. Në rastet kur është e nevojshme vendimarrja për zgjidhjen e situatave konkrete, drejtimi organizativ dhe teknik i operacionit për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet nga specialist i sherbimit pyjore, përgjegjës për zonën,

18. Sektori i monitorimit dhe sherbimit pyjor, specialistët përgjegjës pranë njesive administrative, shërbimet e policisë bashkiake, inspektoriati i kontrollit të territorit, dhe ato të shërbimit zjarrfikës, mbajnë kontakte të vashdueshme me strukturat e policisë pyjore dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, ku krahas kontributit për sensibilizimin e komunitetit për marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, marrin të gjitha masat për zbulimin, gjetjen dhe venjen përpara përgjegjësisë ligjore të personave zjarrvënës.

Specialistët përgjegjës për zonen pyjore, Shërbimit zjarrfikes, Inspektoriati i Kontrollit të Territorit, dhe Policia bashkiake - vazhdimisht.

19. Strukturat përgjegjëse të administrimit të fondit pyjorë dhe kullosorë pranë bashkisë hartojnë një plan - veprimi të përbashkët me strukturat e shërbimit zjarrfikës , për raste kur do të përdoren forcat

zjarrfikëse dhe mjetet e tyre në operacionet izolimit dhe fikjes se zjarreve në zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë.

Përgjegjësi i sektorit të pyjeve dhe ai i shërbimit zjarrfikës, deri me datë 16.05.2022

20. Në buxhetin vjetor për sektorin e pyjeve dhe kullotave planifikohet një fond operativ për mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarri, për:

a). Organizimin dhe funksionimin e përhershëm të sistemit të analizës së të dhënave e për përcaktimin e rasteve të vendimmarrjes për të ardhmen, si dhe për mbajtjen e skuadrave zjarrfikëse pranë organeve të shërbimit pyjor, dhe qeverisjes vendore.

b). Organizimin e sistemit të vrojtim/sinjalizimit në të gjithë territorin e bashkise Mirdite, për fushatat e sensibilizimit e të ndërgjegjësimit të publikut, për rrezikun e zjarreve në pyje dhe kullota;

c). Kryerjen e punimeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve dhe reduktimin e pasojave të tyre (pastrime, rrallime, hapje brezash, kulla vrojtimi etj).

ç). Eliminimin e pasojave të zjarreve (hedhje fare, mbjellje, punime për frenimin e erozionit etj).

d). Shpërblimin e të aksidentuarve në rastet e pjesëmarrjes në shuarjen e zjarreve në pyje;

e). Dhënien e stimujve materialë për rastet e kontributeve të veçanta për këtë qëllim;

ë). Përmirësimin e logjistikës me mjete e pajisje dhe të infrastrukturës mbështetëse në përgjithësi.

21. Mënyra e pagesës dhe e shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përcaktojnë mënyrën e lëvrimit të fondeve në rastet e emergjencave civile.

Personat përgjegjes, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit e bashkisë Mirditë deri me 27.05.2022

22. Për zbatimin e këtij plan masash, ngarkohen Agjencia e Sherbimeve Bujqesore Veterinare dhe Pyjore, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, Sherbimi zjarrfikes dhe Njesitë administrative etj.

23. Me këtë plan masash, njihen dhe pajisen me nga një kopje të gjitha strukturat në vartësi të Bashkisë Mirditë.

P/Sek. Mont.Shërbimit Pyjore
Ing. Ing. Eneida NIKOLLI

AGJENCIA SH B V P
D R E J T O R I

Tanush MARKU

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1252/1 Prot.

Rrëshen me, 29 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr. 27 datë 29. 03. 2022

PËR
"MIRATIM E TAVANEVE PERGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025", BASHKIA MIRDITË.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr.68/2017, pika 3, neni 48, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9, datë 12.07.2018 , i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 , i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar me Udhëzimin nr.7, datë 25.02.2022, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2023" të kalendarit të PBA-së, të miratuar me VKB. nr. 8, datë 31.01.2022, si dhe projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, *diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e Komisionit të Financave dhe Ekonomisë,* për t'a kaluar në seancë e këshillit bashkiak, pas diskutimeve në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë tavanet pëgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor, të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023 - 2025, sipas tabelave bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e menaxhimit financiar dhe e buxhetit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015,"Për vetëqeverisjen vendore"të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

S E K R E T A R

Gasper TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

K R Y E T A R

Pjeter PJETRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MIRDITË

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(D1) TAVANET

		2023	2024	2025
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
1	**Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë**			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	59,829	59,829	59,829
	Të tjera shpenzime korrente	22,053	23,000	23,000
	Shpenzimet kapitale	2,000	2,171	2,171
	Tavanet e përgjithshme	83,882	85,000	85,000
2	**Punët Publike dhe Mirëmbajtja**			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	32,516	43,218	43,500
	Të tjera shpenzime korrente	9,313	10,000	15,000
	Shpenzimet kapitale	29,291	29,302	39,520
	Tavanet e përgjithshme	71,120	82,520	98,020
3	**Siguria Publike**			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	40,490	40,490	40,490
	Të tjera shpenzime korrente	50,972	53,000	53,000
	Shpenzimet kapitale	17,065	21,527	21,527
	Tavanet e përgjithshme	108,527	115,017	115,017
4	**Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti**			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	122,736	122,736	122,736
	Të tjera shpenzime korrente	29,226	30,000	30,000
	Shpenzimet kapitale	10,390	0	0
	Tavanet e përgjithshme	162,352	152,736	152,736
5	**Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet**			
	Pagat dhe sigurimet shoqërore	22,940	22,940	22,940
	Të tjera shpenzime korrente	3,998	3,000	3,000
	Shpenzimet kapitale	11,717	12,715	12,715
	Tavanet e përgjithshme	38,655	38,655	38,655
	TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE	278,511	289,213	289,495
	TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE	115,562	119,000	124,000
	TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE	70,463	65,715	75,933
	TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME	464,536	473,928	489,428

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja					300	300	300
A.3.5.1	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave							
A.3.5.1	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille							
A.3.5.1	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)							
A.3.5.1	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj							
A.3.6	**Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj**							
A.3.6.1	Bibloteka	-	-	-	-	3,940	3,940	3,940
A.3.6.2	Muzeumet							
A.3.6.3	Teatri							
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve							
A.3.6.5	Pallati i sportit							
A.3.6.6	Qendra Komunitare							
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)							
A.3.6.8	Kopshtet							
A.3.6.9	Çerdhet							
A.3.7	**Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime**					1,980	1,980	1,980
A.3.8	**Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit**					1,960	1,960	1,960
A.3.9	**Tarifa e përkohëshme**							
A.3.10	**Tarifa të tjera**							
A.4	**TË ARDHURAT E TJERA**	-	-	-	-	3,100	3,100	3,100
A.4.1	**Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë**					821	821	821
A.4.2	**Kthimi nga investimet kapitale**					821	821	821
A.4.3	**Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë**							
A.4.4	**Kthimi nga partneriteti publik privat**							
A.4.5	**Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet**							
A.4.6	**Shitja e mallrave dhe shërbimeve**							
A.4.7	**Kundravajtjet administrative (Gjobat)**							
A.4.8	**Sekuestrime dhe Zhdëmtime**							
A.4.9	**Kuotat e anëtarësisë së bashkive**							
A.4.10	**Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore**							
A.4.11	**Grante nga ndihma ndërkombëtare**							
A.4.12	**Shitja e aseteve financiare**							
A.4.13	**Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme**							
A.4.14	**Të tjera**							
B	**TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR**	-	-	-	-	389,536	403,928	419,428
B.1	**Transferta e pakushtëzuar**					221,062	235,454	250,954
B.2	**Transferta e kushtëzuar**	-	-	-	-	-	-	-
B.2.1	**Për funskionet e deleguara**							
B.2.2	**Për projekte të veçanta**							
B.3	**Trasferta specifike**							
C	**HUAMARRJA**	-	-	-	-	168,474	168,474	168,474
C.1	**Huamarrja afatshkurtë**					-	-	-
C.2	**Huamarrja afatgjatë**							
D	**TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR**	-	-	-	-	-	-	-
D.1	**Trashëgimi pa destinacion**							
D.2	**Trashëgimi me destinacion**							
	TOTALI I TË ARDHURAVE (A+B+C+D)	0	0	0	0	464,536	473,928	489,428

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË SEKRETARIA

A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja					300	300	300
A.3.5.1	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave							
A.3.5.1	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille							
A.3.5.1	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)							
A.3.5.1	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj							
A.3.6	**Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj**							
A.3.6.1	Bibloteka	-	-	-	-	3,940	3,940	3,940
A.3.6.2	Muzeumet							
A.3.6.3	Teatri							
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve							
A.3.6.5	Pallati i sportit							
A.3.6.6	Qendra Komunitare							
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)							
A.3.6.8	Kopshtet							
A.3.6.9	Çerdhet							
A.3.7	**Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime**					1,980	1,980	1,980
A.3.8	**Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit**					1,960	1,960	1,960
A.3.9	**Tarifa e përkohëshme**							
A.3.10	**Tarifa të tjera**							
A.4	**TË ARDHURAT E TJERA**					3,100	3,100	3,100
A.4.1	**Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë**	-	-	-	-	821	821	821
A.4.2	**Kthimi nga investimet kapitale**					821	821	821
A.4.3	**Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë**							
A.4.4	**Kthimi nga partneriteti publik privat**							
A.4.5	**Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet**							
A.4.6	**Shitja e mallrave dhe shërbimeve**							
A.4.7	**Kundravajtjet administrative (Gjobat)**							
A.4.8	**Sekuestrime dhe Zhdëmtime**							
A.4.9	**Kuotat e anëtarësisë së bashkive**							
A.4.10	**Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore**							
A.4.11	**Grante nga ndihma ndërkombëtare**							
A.4.12	**Shitja e aseteve financiare**							
A.4.13	**Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme**							
A.4.14	**Të tjera**							
B	**TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR**	-	-	-	-	389,536	403,928	419,428
B.1	**Transferta e pakushtëzuar**					221,062	235,454	250,954
B.2	**Transferta e kushtëzuar**	-	-	-	-	-	-	-
B.2.1	**Për funskionet e deleguara**							
B.2.2	**Për projekte të veçanta**							
B.3	**Trasferta specifike**							
C	**HUAMARRJA**	-	-	-	-	168,474	168,474	168,474
C.1	**Huamarrja afatshkurtë**					-	-	-
C.2	**Huamarrja afatgjatë**							
D	**TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR**	-	-	-	-	-	-	-
D.1	**Trashëgimi pa destinacion**							
D.2	**Trashëgimi me destinacion**							
	TOTALI I TË ARDHURAVE (A+B+C+D)	0	0	0	0	464,536	473,928	489,428

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA MIRDITË

BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1250/2 Prot.

Rrëshen me, 29. 03. 2022

V E N D I M

Nr. 28 datë 29. 03. 2022

PËR
"MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ", BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 75/2019 "Për rininë", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Mirditë, pas diskutimeve,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (këtu e në vijim referuar shkurtimisht si KVR) si edhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.

2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.

3. KVR përbëhet nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) anëtarë, ku të respektohet parimi i barazisë gjinore.

4. KVR do të ketë në përbërje:

   a. Kryetari i Bashkisë, kryetar;
   b. Përfaqësues i Këshillit Bashkiak ose administratës (sektori i rinisë) së njësisë administrative, anëtar;
   c. 2 përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë);
   d. 2 përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë Administrative (anëtarë).

5. Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.

6. Anëtarët e KVR mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim kryetarin. Kryetari mund të vendosë edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mosparaqitjes në takime për më shumë se 2 herë rradhazi ose në raste të tjera të mospërmbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson.

7. Anëtarët e KVR identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

8. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga këshilli bashkiak dhe/ose administrata e njësisë administrative bëhet nga kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projekte që lidhen me të rinjtë.

9. Përzgjedhja mes kandidatëve përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë, bëhet nga kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

   a. te jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
   b. të mos jetë i dënuar;
   c. të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
   d. të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të KVR;

10. Kandidatët për KVR, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

    a. kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin për aplikim;
    b. jetëshkrim (CV);
    c. fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
    d. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
    e. vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
    f. referenca nga të paktën 2 bashkëpunëtorë të mëparshëm;

11. `Kandidatët për KVR, përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë Administrative duhet të përmbushin këto kritere:

    a. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
    b. të jetë përfshirë në organizimin apo në zbatimine aktiviteteve rinore, apo në promovimin e të rinjve;
    c. të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR;

12. Kandidatët për KVR, përfaqësues nga të rinj aktiv të njësisë administrative duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

    a. kërkesë me shkrim;

b. jetëshkrimin (CV);
c. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
d. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
e. letër interesi/motivimi;
f. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

13. KVR mblidhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari.

14. Veprimtaria e KVR mbështetet nga sekretari teknik, që është një punonjës i bashkisë i ngarkuar nga kryetari me këtë detyrë.

15. Sekretari teknik njofton anëtarët e KVR jo më vonë se 7 ditë përpara për datën dhe orën e takimit si dhe rendin e ditës. Sekretari teknik mban minutat e takimit dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me veprimtarinë e KVR.

16. Mbledhjet e KVR zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.

17. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

KRYETAR

Pjeter PJETRI

BASHKIA MIRDITË

Nr. 1250 Prot.

Rrëshen, me 23.03.2022

RELACION

"Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË

Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak,

Pas miratimit të ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë" nga Parlamenti i Republikës së Shqipëris, ligj i cili ka për objekt mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë na lind detyrimi si bashki që në mbështetje të neneve 7 dhe 10 të këtij ligji të sjellim përpara jush ketë projekt vendim.

Projekt - Vendimi i paraqitur do te bejë të mundur zbatim e pikës 3 të Nenit 10 te ligjit nr.75/2019 Per Rininë të miratojë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij, kritere dhe procedura të cilat janë ndjekur nga qeveria nëpërmjet Agjensis Kombëtare të Rinisë për ngritjen e Këshillit Rinorë Kombëtar dhe u janë përcjellë bashkive të shqipëris si udhëzim për ngritjen e Këshillave Rinorë Vendorë.

Të ndodhur përpara të tillë faktesh me datë 15 Mars 2022 bashkia nëpërmejt Njesis së Integrimit Evropian dhe Ndihmë së Huaj organizoi një takim konsultues rreth këtij procesi me të rinj nga Qeveria e Nxënësve të Gjimnazit Rreshen dhe të rinj të tjerë aktiv rreth kësaj tematike. Të rinjt e përkrahën këtë nisëm të bashkisë dhe u shpehën pozitiv për munësinë që po ju jepej për të patur një forum ku mund ti drejtojnë dhe ngrejnë shqetësimet edhe nevojat e tyre.

Prandaj po kerkojmë nga ana juaj votimin në mbledhjen e radhës [redacted]